VENDIM
Nr.427, datë 21.3.2006

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT
"PËRMETI"
SUBJEKTIT FIZIK: GJERGJI PETRO

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radio e televizivë analogjik tokësor, në nivel vendor" të miratuar me vendimin nr.355 pika 1, datë 29.8.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.405, datë 20.12.2005 të KKRT-së "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë, radio e televizivë", si dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit fizik z.Gjergji Petro licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Përmetit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj